

Eneida Lajqi, MA¹

UDC:
347.711(497.115)

**KONTRATA E SHITJES KARAKTERISTIKAT, NATYRA DHE
DOMOSDOSHMEËRIA E SAJ NË QARKULLIMIN E MALLRAVE
BRENDA TREGUT**

**ДОГОВОР ЗА ПРОДАЖБА, НЕГОВИТЕ КАРАКТЕРИСТИКИ,
ПРИРОДА И НЕОПХОДНОСТ ВО ПРОЦЕСОТ НА СТОКИ
ВО ПАЗАРОТ**

**THE CONTRACT OF SALES ITS CHARACTERISTICS, NATURE,
AND NECESSITY IN THE CIRCULATION OF GOODS WITHIN
THE MARKET**

Abstract:

Process of goods circulation and offer of services is a process that characterizes the companies since the time of commodity exchange, specifically during the period when the money did not exist and was not a buying instrument. In the old times in which the market has not been systemized as it is nowadays, the purchase and sale of items did not have the importance that it has nowadays. In the early period of Roman history, the economy had features of the classical slave-owner economy, where slaves were the basis for ensuring income or financial gain. Slaves were obliged to do all the work, forced by the owners who used them as manpower and stuff and never treated them as people. In this period, goods were shared between slaves and their families and thus, goods and services were generated, within the market in old Rome. In this period, trade was divided into retail trade and wholesale trade.

¹ Master of civil law and property rights, University of Pristina "Hasan Prishtina", str "Agim Ramadani 10000, Prishtinë, (eneidalajqi@hotmail.com)

Retail trade was practiced by small people, while the wholesale trade by all those people of power who were free to trade all over the world. Nowadays, the market does not function in this way, the supply of goods and services within the markets of moderate states with a developed economy is made by building the necessary and secure legal basis for the purchase and sale of goods and the provision of services. Sales contract is one of the most frequent contracts in selling and buying items. A sales contract is an agreement between a buyer and seller covering the sale and delivery of goods which characterizes Kosovo's market and other markets, what will be discussed during this paper.

Keywords: Goods, market, sales contract.

Hyrje

Të jetosh brenda një ekonomie të zhvilluar dhe produktive nënkupton të jetosh brenda një hapësire gjeneruese të të mirave, qofshin ato të mira që janë objekt shitje apo edhe të holla të cilat merren pas shitjes së sendit. Me ekonomi gjeneruese dhe produktive nënkuptojmë atë që një shtet ka një treg prodhues brenda të cilit qarkullojnë të mira, konkretisht mallra për të përmbushur nevojat e përgjithshme shoqërore. Në qarkullimin e të mirave, ligji kontraktor luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.² Kjo nuk do të thotë aspak se po mbivlerësohet një fushë e së drejtës në raport me fushat e tjera, por sigurisht nuk mund të mohohet rëndësia që ka në rregullimin e praktikave të shkëmbimit, marrëveshjeve dhe tregtisë, duke u kthyer në “gjuhën e përbashkët” të popujve.³ Fusha e zbatimit të ligjit kontraktor përfshinë fushën brenda së cilës zbatohen edhe kontratat. Fusha e zbatimit të kontratave është e gjerë, ato zbatohen në shumë degët të së drejtës. Në të drejtën biznesore më së shumti zbatohet kontrata për qarkullimin e mallrave dhe kryerjen shërbimeve.⁴ Nocioni i kontratave dhe të drejtës private në tërësi është shumë i gjerë dhe varion nga kuptimi varësisht prej shteteve. Në shumë legjislacioneve normohet se

² Brunela Kullolli, “*Interpretimi i Kontratave*”-Studim Krahasues”, hyrje, XVI, Universiteti i Tiranës, 2017. E disponueshme edhe në www.doktoratura.unittir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Interpretimi-i-Kontratave-Studim-Krahasues-Brunela-Kullolli.pdf

³ Po aty.

⁴ Dr. Armand Krasniqi, “*Natyra juridike dhe rëndësia e kontratës për menaxhimin e ndërmarrjeve biznesore në veshtrim teorik-praktik*”, f. 2, e disponueshme edhe në http://www.dukagjinicollege.eu/empirikus1/269_279_armand_krasniqi.pdf

e drejta civile është pjesë e të drejtës private.⁵ E drejta private përbëhet nga e drejta civile dhe tregtare.⁶ Sipas të drejtës gjermane, ajo çka e përcakton apo personifikon më së miri të drejtën private është kontrata private e lidhur mes palëve, të cilën e karakterizon oferta.⁷ Kodi civil gjerman parasheh se: çdo person që i ofron një tjetri për të hyrë në një kontratë është i detyruar nga oferta, përveç nëse ai nuk e ka përjashtuar të qenit i detyruar nga oferta.⁸ Pra, kontrata është një institut i rëndësishëm i normimit të marrëdhënieve kontraktuale, prandaj edhe përgjatë këtij punimi do të flitet për kontratën e shitblerjes, si kontratë me peshë në qarkullimin e mallrave.

Vështrim evolues i kontratës së shitjes

Nga një vështrim *prima facie*, duke iu referuar edhe evoluimit historik por edhe deduksioneve në trajtesat e sintetizuara nga e drejta e krahasuar, evidentojmë se, e drejta kontraktore ka pasur një vëmendje të veçantë, për shkak të impaktit të madh që kjo e drejtë ka në marrëdhëniet juridike mes individëve të shoqërisë në të cilën ne jetojmë.⁹ Kjo degë e së drejtës paraqitet qysh në antikitet. Siç u cekë edhe më lartë në kohërat më të hershme njerëzit kanë shkëmbyer vetëm mallin me mall, derisa paraja nuk ka qenë mjet për pagesën e sendeve apo kryerjen e shërbimeve, me ç'rast vlera e vërtetë e një sendi ka qenë e vështirë që të përcaktohej, prandaj edhe tregjet nuk e kanë pasur performancën dhe rëndësinë të cilën e gëzojnë në ditët e sotme. Kontrata e shitblerjes është një ndër kontratat me të vjetra edhe në blerjen dhe shitjen e sendeve në mes shqiptarëve. Kjo kontratë daton qysh nga kohërat ilire, ku normat juridike të shtetit Ilir rregullonin dhe sanksiononin institutin e parblerjes.¹⁰ Për kontratën e shitblerjes flitet edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ky kanun këtë kontratë e rregullonte pa kushte, me kapar,

⁵ Abdulla Aliu, “*E drejta civile*”, f. 22, Prishtinë, 2013.

⁶ Merryman, John, Henry, “*Tradita e së drejtës civile*”, (*The Civil Law Tradition*), përkthyer nga Stavri Pone dhe Irena Kola, f. 104. Tiranë, 1993.

⁷ Më gjer. shih, “*Kodin Civil Gjerman (BGB)*”, kapitulli i tretë, seksioni 145, pjesë e seksionit në të cilën rregullohen detyrimet e përgjithshme, ku konkretisht flitet për ofertën dhe efektin e ofertës në lidhjen e kontratës.

⁸ Po aty.

⁹ Brunela Kullolli, “*Interpretimi i Kontratave*”-*Studim Krahasues*”, f. 1, Universiteti i Tiranës, 2017. E disponueshme edhe në www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Interpretimi-i-Kontratave-Studim-Krahasues-Brunela-Kullolli.pdf

¹⁰ Nerxhivane Dauti, “*E drejta e detyrimeve*”, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, botim i plotësuar dhe ndryshuar, f. 298, Prishtinë, 2008.

dhe me dëshmitarë.¹¹ Në nenin 425 të kanunit thuhej se në rast se një send blihej me kushte dhe paraqitej më vonë me te meta, ai send i kthehej shitësit.¹² Ndërsa, në ditët e sotme kontrata ka një koncept mjaft modern, ajo cilësohet si një marrëveshje e lirë në mes dy apo më shumë palëve dhe konsiderohet e lidhur kur palët kontraktuese bien dakord për elementet thelbësore të kontratës.¹³ Kjo kontratë cilësohet si një marrëveshje shumë e rëndësishme në përcaktimin e saktë të të drejtave dhe detyrime konkrete në mes palëve kontraktuese.

Rëndësia e kontratës së shitjes brenda tregut të Republikës së Kosovës

Tregu i Republikës së Kosovës i cili karakterizohet nga një ekonomi jo edhe shumë të zhvilluar, përballet me problematika të ndryshme të cilat i përkasin edhe fushës ligjore, por edhe asaj financiare në tërësi. Edhe në tregun e Kosovës ashtu si në te gjitha tregjet tjera të shitblerjes dhe ofrimit të shërbimeve baza ligjore ka një rëndësi të veçantë në themelimin e marrëdhënieve të dyanshme detyruese në mes të dy apo më shumë palëve. Një nga kontratat e cila dominon dhe dukshëm është e shprehur brenda këtij tregu në fushën e qarkullimit të mallrave dhe krijimit të marrëdhënieve kontraktuale të dyanshme detyruese, është kontrata e shitblerjes si një kontratë mjaft e rëndësishme në aspektin e blerjes dhe shitjes së sendeve. Lidhja e kontratës së shitjes ndodhë në momentin kur dy apo më shumë persona vendosin që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale në mes vete, për shitjen dhe blerjen e një sendi të paluajtshëm, apo edhe të luajtshëm. Kjo kontratë lidhet pas pranimit të ofertës dhe kushteve të ofertës nga personi të cilit i drejtohet oferta, konkretisht pas negociatave të bëra në mes palëve. Një ofertë apo letër negociuese “letër e një qëllimi” konsiderohet si marrëveshje e palëve për t’u pajtuar lidhur me kushtet e mëvonshme të kontratës, prandaj bazuar në këto simbolika të kësaj kontrate shumë njerëz refuzojnë që të negociojnë.¹⁴ Për shembull, ka shumë raste kur njerëzit refuzojnë të blejnë një veturë për shkak te negociatave lidhur me çmimin,¹⁵ sepse, kjo kontratë si rregull u nënshtrohet disa detyrimeve dhe formës së paraparë ligjore, dhe disa kushteve përpara lidhjes së

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ Abdulla Aliu, “E drejta civile”, f. 364, Prishtinë, 2013.

¹⁴ Richard Stim, “Contracts: The Essential Business Desk Reference,” f. 26

¹⁵ Stephen Guth, “The Contract Negotiation Handbook,” f. 1, USA, 2008.

kontratës siç ishte negocimi paraprak në mes të palëve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kontratës së shitjes është edhe çmimi i sendit që është objekt i shitjes në mes palëve kontraktuese. Çmimi përcaktohet me kontratë nga ana e palëve kontraktuese, dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të re të palëve. Të dy palët kontraktuese dakordohen për format dhe mënyrat e caktimit të çmimit. Si rregull çmimi caktohet në monedhë vendore, por mund të caktohet edhe në monedhë të huaj, varësisht prej asaj se si dakordohen palët në mes vete. Pagimi i çmimit kontraktues si rregull bëhet në momentin e lidhjes së kontratës, mirëpo mund të paguhet edhe në ndonjë moment tjetër, në rast se kontraktuesit merren vesh ndryshe. E rëndësishme të theksohet është se, në momentin kur shitet një send i paluajtshëm para pagimit të çmimit, të dy palët duhet të kenë kujdes që kontratën ta lidhin në formën e paraparë ligjore, me të dhëna të mjaftueshme për të dy palët, në mënyrë që pronësia të kalojë tek personi tjetër, si dhe kjo e drejtë të njihet më vonë nga personat e tretë. Ndërsa, në të gjitha rastet e tjera ku për objekt shitje është sendi i luajtshëm bartja bëhet vetëm me kalimin e sendit prej një dore në tjetrën, konkretisht prej shitësit tek blerësi e njohur ndryshe edhe si dorëzim formal i sendit. Prandaj, forma e kontratës e përpiluar me shkrim dhe në mënyrën adekuate ligjore është mjaft e rëndësishme në të gjitha rastet kur kemi të bëjmë me shitje të sendeve të paluajtshme. Kontrata e shitjes ashtu si edhe çdo marrëveshje tjetër duhet që gjithmonë të lidhet me mirëbesim. Mirëbesimi si parim i kontratave dhe marrëdhënieve detyruese aplikohet në gjithë të drejtën e detyrimeve, dhe jo vetëm në të drejtën e kontratave.¹⁶ Për më tepër, përtej sferës së të drejtës së detyrimeve, mirëbesimi ndonjëherë ndikon thuajse në të gjithë të drejtën private.¹⁷ Ky koncept gjendet në disa fusha si tek e drejta familjare, e drejta e pronësisë, si dhe tek e drejta e trashëgimisë apo tek dhurimi.¹⁸ Mirëpo, ky parim është dukshëm më i theksuar në të drejtën kontraktore. Instituti i mirëbesimit edhe pse juridikisht nuk sanksionohet, ka për qëllim veprimin e palëve kontraktuese me idenë që të veprohet sipas kushteve të kontratës. Edhe legjislacioni i Kosovës e parasheh

¹⁶ Më gjerësisht shih. nenin 242 të *Kodit Civil Gjerman (BGB)*, pjesë e seksionit në të cilën rregullohen detyrimet e përgjithshme.

¹⁷ Brunela Kullolli, “*Interpretimi i Kontratave*”-*Studim Krahasues*”, fq 227-228, Universiteti i Tiranës, 2017. E disponueshme edhe në [www. http://www.doktoratura .unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Interpretimi-i-Kontratave-Studim-Krahasues-Brunela-Kullolli.pdf](http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Interpretimi-i-Kontratave-Studim-Krahasues-Brunela-Kullolli.pdf)

¹⁸ Po aty.

mirëbesimin si një parim bazë i kontratave. Në tregun e Kosovës kontrata e shitjes ka një rëndësi të madhe dhe është njëra prej kontratave me të shpeshta të lidhura. Kontrata si e drejtë dhe detyrim në marrëdhëniet e dyanshme kontraktuale krijon të drejta dhe detyrime konkrete për të gjithë personat të cilët krijojnë këto marrëdhënie. Kur flasim për rëndësinë të cilën e ka kontrata e shitjes që në kuadër të tregut të mundësohet shitblerja apo qarkullimi i mallrave, duhet të ndalemi në disa aspekte kryesore të vrojtimit të natyrës së kësaj kontrate, me kusht që të arrijmë të vlerësojmë të mirat dhe avantazhet e kësaj kontrate në procesin e qarkullimit të mallrave. Në ditët e sotme, kontrata e shitblerjes kur ka për objekt shitje sende të paluajtshme në vlera të mëdha mund të blihet me kredi. Vlen të theksohet se, gjatë viteve 1930 në shumicën e shteteve perëndimore, pronarët e shtëpive blinin me kredi shumë më të shkurtra të cilat zgjasnin 3 deri në 5 vjet, krahasuar me kreditë e sotme të cilat zgjasin prej 20 deri në 30 vite.¹⁹ Prandaj, siç u cek edhe më lartë në momentin që blihen sende të paluajtshme është e domosdoshme që kontrata të ketë formën me shkrim, sepse po të mos ekzistonte baza ligjore apo një marrëveshje që ka peshë në saktësimin e të drejtave dhe detyrimeve në mes palëve kontraktuese në momentin që dy apo më shumë persona krijojnë një marrëdhënie, qoftë shitblerje qoftë lloj tjetër të kontratës, njerëzit nuk do arrinin t'i njihnin të drejtat e tyre, dhe personat e pandërgjegjshëm do ishin të lirë t'i iknin detyrimit.

Natyra e kontratës së shitblerjes në qarkullimin e mallrave

Kontrata e shitblerjes është kontratë për shkëmbimin e mallrave, shërbimeve të tjera ose pronës nga shitësi tek blerësi për një vlerë të rënë dakord, e njohur ndryshe si shumë ekuivalente. Subjektet që lidhin kontratë mbi shitjen janë shitësi dhe blerësi, të cilët janë palë kontraktuese me këtë kontratë.²⁰ Një kontratë konsiderohet e vlefshme kur palët bien dakord për kushtet elementare të kontratës, sipas marrëveshjes të bërë me gojë apo me shkrim. Qëllimi i lidhjes së kontratës së shitjes është mbrojtja e blerësit dhe shitësit. Siç shihet nga kjo kontratë doktrina e performancës substanciale ka për qëllim që të kufizojë blerësin ndaj dëmeve të matura nga diferenca midis vlerës së premtimit të

¹⁹ Richard Stim, “*Contracts: The Essential Business Desk Reference*”, f. 26

²⁰ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, “*E drejta e detyrimeve*”, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, botim i plotësuar dhe ndryshuar, f. 295, Prishtinë, 2008.

mallrave dhe mallrave të dorëzuara.²¹ Kontrata e shitblerjes është një kontratë shumë e shpeshtë dhe mjaft e domosdoshme në shitje dhe blerje si praktikë e përditshme shoqërore. Në jetën e përditshme ne si njerëz pothuajse çdo ditë përballemi me shitje dhe blerje të sendeve, konkretisht qarkullim të mallrave, qoftë prej një dore në dorën tjetër në mënyrë të thjeshtë, qoftë në formë të shkruar me lidhjen e kontratës së shitblerjes tek personat kompetent. Në momentin që ne hyjmë në market dhe blejmë mallra të ndryshme që nga ajo më e lira e deri te ajo më e shtrenjta, ne krijojmë një marrëdhënie të dyanshme detyruese me shitësin e mallrave. Edhe pse përgjatë blerjes në rastet kur kemi të bëjmë me blerjen e sendeve të luajtshme, kur merret malli dhe paguhet çmimi nuk lidhet një kontratë formale, marrëdhënie të dyanshme detyruese në mes shitësit dhe blerësit krijon fatura e cila paguhet në momentin që dorëzohen sendet. Shitësi është i obliguar që për çdo mall të shitur ose shërbim të ofruar për konsumatorin të jap faturë e cila duhet të jetë e saktë, e pashlyeshme, e qartë, e dukshme dhe e lexueshme në letër apo formë elektronike.²² Në bazë të saj dihen saktë lloji i sendeve të blera, çmimi i tyre, koha apo orari i pagesës, si dhe vendi ku është bërë qarkullimi i sendeve të luajtshme. Si çdo marrëdhënie tjetër kontraktuale dhe detyruese që vepron vetëm ndaj personave të cilët hyjnë në këto marrëdhënie, dhe jo ndaj palëve të treta e njohur në gjuhën latine si marrëdhënie **inter-partes**, edhe kjo kontratë vepron vetëm ndaj personave të cilët krijojnë raporte kontraktuale përmes shitjes dhe blerjes së sendit. Në momentin kur shkëputet kontrata e shitjes dhe dëmtohet pala tjetër kontraktuese, apo në rast se kemi të bëjmë me një dëm të shkaktuar drejt palës tjetër ekzistojnë disa mënyra të mbrojtjes së palës së dëmtuar, por dy më të shprehurat në shumicën e legjislacioneve të shteteve perëndimore janë kthimi dhe dëmshpërblimi, ku pala e dëmtuar është e lirë që të zgjedh njërën prej këtyre me qëllim që të mbrojë të drejtat dhe interesat e saj.²³ Format e dëmshpërblimit janë paraparë për shkak se janë të shumta rastet kur kontratat lidhen me mashtrimin e njëjës palë gjë që mund të rezultojë më vonë me shkëputje të kontratës nga ana e palës tjetër.

²¹ Marvin A. Chirelstein, "Concepts and case analysis in the law of contracts" f. 126, Foundation Press, fourth edition.

²² Shih, "Ligji për mbrojtjen e Konsumatorit i Republikës së Kosovës", nr. 04/L -121, neni 12, par.1, ku thuhet se shitësi është i obliguar që t'i ofrojë blerësit faturën e qartë, të saktë, të pashlyeshme dhe të lexueshme në letër dhe formë elektronike, përmes këtij neni mbrohet pozita e konsumatorit në blerjen e sendeve përmes faturës e cila duhet të specifikojë qartë dhe saktë sendet e blera nga blerësi.

²³ Marvin A. Chirelstein, "Concepts and case analysis in the law of contracts", f. 185, Foundation Press, fourth edition.

Mashtrimi cilësohet si një paraqitje e rremë e një fakti të bërë me njohuri nga pala tjetër, apo në mospërfillje të pamatur nga pala e panjohur me atë fakt nëse ai është e vërtetë i rremë.²⁴ Për të ekzistuar mashtrimi prezantimi i kushteve të kontratës duhet të bëhet me dijeninë e gënjeshtres së palës tjetër.²⁵ Prandaj, është e domosdoshme që kontrata të ketë një formë të caktuar kur shiten sendet me vlera të mëdha, me kusht që t'i shmangemi formave të ndryshme të abuzimit me pozitën kontraktuale nga pala e pandërgjegjshme. Kur flasim për lidhjen e kontratës së shitblerjes tek sendet e paluajtshme në formën e shkruar të paraparë më ligj, dhe elementet e tjera të kontratës, paraprakisht është e domosdoshme të ndalemi në natyrën e kësaj kontrate për të analizuar edhe rëndësinë juridike të saj. Në rast se analizojmë kontratën e shitblerjes si në literaturën juridike ashtu edhe në praktikën e përditshme gjatë shitjes, vërejmë disa elemente të cilat e karakterizojnë këtë kontratë. Së pari, kjo kontratë ka natyrë pothuajse të ngjashme me kontratën e shkëmbimit e cila është përdorë gjatë periudhës në të cilën njerëzit vetëm kanë shkëmbyer mallin me mall. Saktësisht, kontrata e shitjes ka karakteristikat e kontratës së shkëmbimit por jo mall-mall, por mall-para.²⁶ Kjo kontratë parasheh të drejta dhe detyrime thujse të njëjta me kontratën e shitjes. Element tjetër që e karakterizon kontratën e shitjes është edhe ajo se kjo kontratë është kontratë transferuese, si dhe një ndër kontratat kryesore të qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve.²⁷ Në ditët e sotme kontrata ka një koncept mjaft modern, ajo cilësohet si një marrëveshje e lirë në mes dy apo më shumë palëve dhe konsiderohet e lidhur kur palët kontraktuese bien dakord për elementet thelbësore të kontratës.²⁸ Kur e analizojmë kontratën e shitblerjes në kuadër të natyrës së saj juridike është e obligueshme të saktësojmë kuptimin e vërtetë juridik të kësaj kontrate. Dihet se kontrata e shitjes është një ndër kontratat kryesore të qarkullimit të mallrave dhe dhënies së shërbimeve që synon të realizojë interesat ekonomike dhe t'i plotësojë nevojat e palëve që marrin pjesë në lidhjen e saj, qofshin këta persona fizikë, juridik, privat apo shtetëror.²⁹ Sa i përket karakteristikave të saj, kontrata e shitjes është:

²⁴ Sir William R. Anson, *“Principles of the law of contract”*, f. 156, Chicago Callaghan and Company, 1880.

²⁵ Sir William R. Anson, *“Principles of the law of contract”*, f. 160, Chicago Callaghan and Company, 1880.

²⁶ Më gjerësisht shih, Nerxhivane Dauti, *“E drejta e detyrimeve”*, f. 297, pjesa ku flitet për zhvillimin historik të kontratave, Prishtinë, 2008.

²⁷ Nerxhivane Dauti, *“E drejta e detyrimeve”* f. 295, Prishtinë, 2008.

²⁸ Abdulla Aliu, *“E drejta civile”*, f. 364, Prishtinë, 2013.

²⁹ Dr. Mariana Semini, *“Kontrata e shitjes në ekonominë e tregut”*, f. 41, Tiranë, 1995.

- 1) Kontratë formale dhe konsensuale
- 2) Kontratë me shpërblim
- 3) Kontratë e dyanshme detyruese dhe
- 4) Kontratë komutative.³⁰

Prandaj, për të saktësuar kuptimin dhe natyrën juridike të saj, duhet të ndalemi në disa pyetje kryesore. Së pari, është e rëndësishme të kuptojmë se çka realisht nënkupton forma e kontratës së shitjes? Koncepti i njohur deri më tani se për plotfuqishmërinë e kontratës së shitjes nuk kërkohet forma e caktuar në bazë por vetëm që arrihet pajtimi i vullnetit, ndërsa bëhet përjashtim nga kjo rregull kur për objekt shitje janë sendet e paluajtshme,³¹ e sqaron vetëm atë se në cilat raste nevojitet forma e kontratës dhe në cilat jo. Në shumicën e legjislacioneve të shteteve të zhvilluara, formë cilësohet një marrëveshje e përpiluar me shkrim në të cilën taksativisht përmenden të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. E drejta gjermane parasheh se: në të gjitha rastet në të cilat kërkohet forma e posaçme për lidhjen e kontratës, kontrata duhet të nënshkruhet nga emetuesi, me dorën e tij ose me inicialet e tij të noterizuara.³² Sipas të drejtës gjermane, forma e shkruar mund të zëvendësohet me formë elektronike, përveç në rastet në të cilat ligji konkret parasheh diçka tjetër.³³ Pra, formë reale e kontratës cilësohet vetëm marrëveshja në mes të palëve e lidhur në pajtueshmëri me rregullat imperative dhe e dizajnuar me norma dispozitive nga palët kontraktuese. Në të gjitha rastet kur për objekt shitje është sendi i luajtshëm, kontrata e shitjes lidhet vetëm **solo-consensus**, ku palët kontraktuese duhet të shprehin qëllimin e kontraktimit (**animus contrahendi**),³⁴ me vullnetin e lirë të palëve kontraktuese pa ju nënshtruar ndonjë forme të veçantë ligjore. Prandaj, për kontratën e shitjes nuk mund të themi se është vetëm kontratë formale dhe as vetëm kontratë jo formale, ajo paraqitet edhe si kontratë formale por edhe si jo formale apo konsensuale kur kemi të bëjmë me shitje dhe blerje të sendeve të luajtshme. Kur flasim për formën e kontratës, kjo çështje na dërgon drejt një pyetje tjetër, se a është e lirë pala e pandërgjegjshme t'i ikë detyrimit kur blenë një send të luajtshëm në pamundësi të disponimit të

³⁰ Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 296, Prishtinë, 2008.

³¹ Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 295, Prishtinë, 2008.

³² Më gjerësisht shih, “Kodin Civil Gjerman (BGB)”, seksioni 126 pjesë e seksionit në të cilën rregullohen detyrimet e përgjithshme, ku flitet për formën e shkruar të kontratave.

³³ Po aty.

³⁴ Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 81, Prishtinë, 2008.

një dokumenti që vërteton shitblerjen? Përgjigjja është po. Në rast se palët që shesin dhe blejnë një send të luajtshtëm nuk kanë ndonjë dokument që vërteton shitblerjen e sendeve të luajtshme, faturë, çek, kambial apo dokument tjetër valid të transaksioneve, pala e pandërgjegjshme do të ishte e lirë t'i ikë detyrimit. Kjo lidhet edhe me atë se shitblerja e sendeve të luajtshme është më e vështirë të vërtetohet, për shkak se sendet e luajtshme si rregull nuk regjistrohen, dhe si rrjedhojë kjo mund të ndikojë edhe në mospërbushje të detyrimit. Prandaj, është shumë e rëndësishme që në çfarëdo marrëdhënie shitblerje, palët të pajisen me një dokument valid që vërteton transaksionin apo kalimin e sendit dhe të hyrave prej një personi drejt personit apo personave të tjerë. Legjislacionet e shteteve të zhvilluara nuk kanë paraparë formë konkrete kur shiten dhe blihen sendet e luajtshme, por kanë paraparë institutin e mirëbesimit i cili njihet edhe me legjislacionin e Kosovës, si dhe parimet e tjera si për shembull parimi i ndërgjeshmërisë dhe ndershmërisë të cilat që vlejné për të gjithë pjesëmarrësit në marrëdhënie të detyrimeve, si ndërmarrësit edhe individët.³⁵ Mbi këto parime duhet të veprojnë palët kontraktuese sa herë që hyjnë në marrëdhënie kontraktuale. Përveç formës së kontratës, si një element i rëndësishëm i saj paraqitet edhe natyra e dyanshme detyruese e palëve kontraktuese. Tek diça kontrata vetëm njëra palë ka detyrime ndërsa tjetra ka të drejta apo anasjelltas, gjë që dallon nga kontrata e shitjes, tek kjo kontratë palët aq sa kanë të drejta kanë edhe detyrime reciproke. Kontrata e shitjes është po ashtu kontratë me shpërblim. Nocioni shpërblyes i kontratës së shitjes është nocion që shërben për të mbuluar natyrën e dyanshme detyruese të saj përmes së cilës të dyja palët fitojné në të njëjtën kohë. Njihet si kontratë me shpërblim për shkak se për sendin që e merr blerësi paguan çmimin e shitjes dhe merr sendin apo të drejtën e kontraktuar,³⁶ ndërsa shitësi merr çmimin dhe dorëzon sendin. Kjo kontratë është shpërbllyese apo oneroze, për shkak se në rast se blerësi nuk do të blinte atë send, do paraqitej një person tjetër që do e merrte të njëjtin, prandaj për blerësin është një lloj shpërblimi në momentin që ai blenë një send konkret sipas dëshirës së tij. Kjo nënkupton se tek kontratat shpërbllyese ekziston barasvlera e prestimeve.³⁷ Kjo kontratë njihet po ashtu kontratë komutative, për shkak se palët qysh në momentin e lidhjes së saj i dinë të drejtat dhe detyrimet e tyre kontraktuese, dhe kjo

³⁵ Nerxhivane Dauti, “*E drejta e detyrimeve*”, f. 36, Prishtinë, 2008.

³⁶ Nerxhivane Dauti, “*E drejta e detyrimeve*”, f. 82, Prishtinë, 2008.

³⁷ Po aty.

nuk varet nga ndonjë rrethanë e ardhshme, dhe si rrjedhojë asnjëra prej palëve nuk mund të arsyetohet se nuk ka qenë e njoftuar për kushtet e kontratës . Roli i kontratës së shitblerjes në qarkullimin e mallrave brenda tregut nënkupton edhe dhënien e një sigurie për blerësin se sendi do të jepet në formën e paraparë më kontratë, konkretisht pa të meta fizike dhe juridike, brenda kohës së arsyeshme të përcaktuar me kontratë, si dhe në sasinë apo masën e caktuar. Ashtu si çdo kontratë tjetër, edhe kontrata e shitjes si një shkëmbim i ligjshëm i premtimeve mbështetet në frazën latine **pacta sunt servanta**. Lidhja e kontratës së shitblerjes në procesin e qarkullimit të mallrave krijon edhe një siguri juridike në rast të kontestit në mes palëve lidhur me ndonjë të drejtë apo detyrim konkret, sepse kjo kontratë i mundëson palës që t'i drejtohet gjykatës kompetente në rast se pala tjetër e pandërgjegjshme nuk e përmbushë detyrimin kontraktor, apo mundohet që t'i ikë këtij detyrimi në forma të ndryshme apo edhe rastet kur pala tjetër mund të kërkojë një të drejtë të cilën të njëjtit nuk e kanë paraparë me kontratë.

Karakterit i dyanshëm detyruës i kontratës së shitjes

Për te ekzistuar një kontratë dhe për t'u bërë e plotfuqishme është e nevojshme që ajo të lidhet më së paku në mes të dy palëve kontraktuese.³⁸ Dihet se palët kontraktuese në momentin që hyjnë në marrëdhënie detyruese në mes vete kanë për obligim që t'u përmbahen rregullave dhe detyrimeve konkrete në mes tyre, detyrime të cilat lindin si rezultat i kontratës së themeluar në mes palëve kontraktuese. Pasi që marrëdhëniet e detyrimeve janë marrëdhënie dispozitive, gjë që nënkupton se palët kontraktuese kanë të drejtë që vetë të dizajnojnë raportin e tyre juridiko-kontraktues, edhe kontrata nga e cila burojnë detyrimet e palëve lidhet në sajë të vullnetit të vetë palëve dhe kushteve të cilat ata i përcaktojnë, ku të dy palët kanë të drejta dhe obligime reciproke bazuar në natyrën detyruese të kontratës. Detyrim i blerësit brenda tregut është që të pranojë mallrat dhe të paguajë çmimin e shitjes. Blerësi ka të drejtë që të mos paguajë çmimin e shitjes, në rast se sendi është me të meta fizike, si dhe në rast se blerësi arrin në përfundim se sendi është objekt pretendimi nga personat e tretë, me ç'rast si i tillë paraqitet me të meta juridike. Kur sendi është me të meta juridike, shitësit mund t'i zvogëlohet apo t'i kufizohet e drejta e tij mbi atë send, prandaj në të gjitha këto raste është obligim i shitësit që

³⁸ Sir William R. Anson, "Principles of the law of contract", f. 7, Chicago Callaghan and Company, 1880.

paraprakisht të njoftojë blerësin lidhur me të metën. Po ashtu, në rastet kur kemi të bëjmë me lidhje të kontratës sipas specifikacionit apo modelit, nëse mallrat nuk përputhen sipas kërkesës së blerësit, blerësi ka të drejtë që të mos pranojë ato mallra. Sipas legjislacionit amerikan në fushën e kontratave, thuhet se nëse mallrat janë në përputhje me specifikimet e kontratës së shitjes dhe blerësi i refuzon gabimisht, shitësi mund të zgjedhë njërën nga katër opsionet ose një përzierje prej dy ose më shumë opsionesh për mbajtjen e kësaj kontrate.³⁹ Së pari, shitësi mund ta padisë blerësin për dëmin e shkaktuar në rast se shitësi ka pësuar ndonjë dëm nga blerësi.⁴⁰ Shuma e dëmeve për refuzim të gabuar është çmimi i shitjes minus çmimi i tregut të mallrave, i matur në kohën dhe vendin e shitjes.⁴¹ Së dyti, shitësi mund të padisë blerësin për mosshitjen e mallrave, por vetëm nëse mallrat nuk mund të rishiten në rrjedhën normale të biznesit të shitësit ose nëse rrethanat tregojnë se përpjekjet për rishitje do të jenë të pafrytshme.⁴² Së treti, shitësi mund të anulojë kontratën, duke i dhënë fund dërgesave dhe duke rezervuar të drejtën për të paditur për dëmet ose për të mbledhur balancat e papaguara.⁴³ Së katërti, shitësi mund të rishesë mallrat tek një palë e tretë dhe të mbulojë diferencën midis çmimit të shitjes dhe çmimit të rishitjes, plus çdo dëmtim të rastësishëm.⁴⁴ Rivendosja e mallrave të refuzuara padrejtësisht paraqet disa probleme të veçanta. Sipas seksionit 2-706 të UCC (Uniform Commercial Code) të SHBA-së shitja mund të jetë publike ose private.⁴⁵ Shitja private bëhet personalisht nga shitësi, ndërsa shitja publike bëhet me njoftim publik dhe kryhet nga një sherif

³⁹ <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Sales+Law>

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Shih, “*Uniform Commercial Code of United States*”, section 2-706, i botuar për herë të parë në vitin 1952, i cili është një nga aktet uniforme që kishte për qëllim harmonizimin e ligjeve që kishin të bënin me shitjen dhe transaksionet e tjera tregtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), nëpërmjet adoptimit të UCC nga të 50 shtetet, Qarku i Kolumbisë dhe territoret tjera amerikane, konkretisht shih seksionin 2-706, ku flitet për ofertën, kushtet e kontratës, detyrimet e palëve kontraktuese si dhe rregullat e shitjes, ky seksion një kohe u konsiderua seksioni më i paqartë për shkak të disa konfuzioneve që mendohej se paraqiste, prandaj në vitin 2003 u shpallë një version i rishikuar i këtij seksioni, mirëpo i njëjti nuk hyri në fuqi asnjëherë për shkak se nuk u miratua kurrë nga asnjë shtet.

ose në një ankand publik.⁴⁶ Në secilin rast shitja duhet të jetë komercialisht e arsyeshme në metodën, mënyrën, kohën, vendin dhe kushtet.⁴⁷ Për më tepër, shitësi duhet të njoftojë blerësit e rinj se mallrat janë duke u rishitur sipas një kontrate të shkelur për të zbuluar potencialin për konflikt ligjor.⁴⁸ Shitësi që rishet mallrat e refuzuara gabimisht duhet të informojë blerësin origjinal të rishitjes.⁴⁹ Nëse mallrat e refuzuara gabimisht janë arsye për prishjen e kontratës, shitësi nuk ka nevojë të njoftojë blerësin për kohën dhe vendin e rishitjes.⁵⁰ Nëse rishitja e mallrave të refuzuara gabimisht është një shitje publike, vetëm mallrat e identifikuar në kontratë mund të shiten dhe shitja duhet të bëhet në një vend të zakonshëm për shitje publike, me kusht që një vend i tillë të jetë në dispozicion të arsyeshëm.⁵¹ Nëse mallrat nuk janë në pikëpamje të ofertuesve në një shitje publike, njoftimi publik i shitjes duhet të tregojë vendin ku janë vendosur mallrat dhe shitësi duhet t'u japë ofertuesve një mundësi për të inspektuar mallrat.⁵² Shitësit sipas këtij kodi kanë të drejtë që të marrin sasinë e parave apo të mirave për sendin e shitur në bazë të marrëveshjes në kohën e paraparë me kontratë dhe në shumën e kërkuar.⁵³ Për dallim nga Kodi Uniform i SHBA-së, Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve i Republikës së Kosovës shprehimisht thotë se shitësi ka disa obligime të cilat duhen medoemos të përmbushen në mënyrë që një kontratë të konsiderohet e përmbushur. Sipas këtij ligji, shitësi ka për obligim që ta dorëzojë sendin në kohën e paraparë, në mënyrën e paraparë me kontratë, dhe atë send për të cilin palët kontraktuese janë dakorduar.⁵⁴ Poashtu, shitësi ka për obligim që t'i bartë të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me dorëzimin e sendit deri tek blerësi. Shitësi, po ashtu ka për obligim që ta mbrojë blerësin nga mungesat fizike dhe juridike të sendit.⁵⁵ Shitësi është i obliguar që sendin ta dorëzojë në formë dhe gjendje të rregullt, ndërsa në rast se dëmtohet apo zhduket sendi, rrezikun e zhdukjes apo dëmtimin e sendit

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty,

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Shih, "Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve" i Republikës së Kosovës, neni 450.

⁵⁵ Shih, "Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve" i Republikës së Kosovës nga neni 450 deri te neni 470 ku shprehimisht flitet për detyrimet e shitësit.

e bartë shitësi deri në momentin në të cilin sendi kalon tek blerësi.⁵⁶ Shitësi ka edhe për detyrim që të marrë shumën e shitjes në mënyrë, kohë dhe në vend ashtu siç janë marrë vesh palët kontraktuese.⁵⁷ Pos shitësit, edhe blerësi ka disa detyrime specifike të cilat është e nevojshme të kryhen me qëllim që të përmbushët kontrata sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese. Blerësi ka për obligim që ta paguajë çmimin e shitjes në shumën siç janë dakorduar palët kontraktuese dhe në afatin e paraparë me kontratë.⁵⁸ Në rast se blerësi me kohë e ka njoftuar shitësin lidhur me të metat e sendit ka të drejtë që të kërkojë nga shitësi që ta mënjanojë të metën, të ja dorëzojë sendin e ri pa të meta, të kërkojë zbritjen e çmimit apo të kërkojë zgjidhjen e kontratës.⁵⁹ Në të gjitha këto raste blerësi ka të drejtë në shpërblimin e dëmit sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës.⁶⁰ Pavarësisht nga kjo, shitësi i përgjigjet blerësit edhe për dëmin të cilin e ka pësuar ky për shkak të të metave të sendit në të mirat e tjera të veta, dhe këtë sipas rregullave të përgjithshme mbi përgjegjësinë për dëmin, sipas dispozitës së nenit 471, par.3 i LMD-së.⁶¹ Kontrata konsiderohet e mbyllur në kohë atëherë kur ekzekutohet marrëveshja dhe përmbushën të gjitha kushtet që e bëjnë atë marrëveshje efektive.⁶²

Kontrata e shitjes me të drejtë riblerje

Kontrata e shitjes me të drejtë riblerje është një lloj tjetër i kontratës së shitjes. Përmes kësaj kontrate shitësi e rezervon të drejtën që deri në një afat të caktuar ta marrë sërish sendin nga blerësi, saktësisht ta blejë sërish atë send nga blerësi duke ja kthyer blerësit shumën e të hollave të dhëna për atë send.⁶³ Afati i përcaktuar në kontratë për të riblerë sendin duhet të respektohet nga shitësi, në mënyrë që të ribletet sendi. Në Amerikë, një riblerje e njohur ndryshe si “buyback” paraqitet atëherë kur një shitës shet një artikull dhe pastaj e riblenë po të njëjtin nga blerësi,⁶⁴

⁵⁶ Dr.sc Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 305, Prishtinë, 2008.

⁵⁷ Dr.sc Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 308, Prishtinë, 2008.

⁵⁸ Dr.sc Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 309, Prishtinë, 2008.

⁵⁹ Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 309, Prishtinë, 2008.

⁶⁰ Shih, “Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve” i Republikës së Kosovës, kreu 6, neni 506.

⁶¹ Shih, “Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve” i Republikës së Kosovës neni 471, par.3 i LMD-së.

⁶² Charles, M.Fox, “Working With contracts, What law school doesn’t teach you”, chapter 2, f. 54, second edition, practising law institute.

⁶³ Dr.sc Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 315-316, Prishtinë, 2008.

⁶⁴ <https://finance.zacks.com/seller-buyback-11079.html>.

një riblerje në sistemin amerikan është një dispozitë e veçantë e kontratës së shitjes ku palët bien dakord që shitësi sërish ta blejë sendin ose pronën me një çmim të caktuar brenda një afati të caktuar.⁶⁵

Kontrata e shitjes me kredi

Kontrata e shitjes me kredi është një lloj kontrate përmes së cilës shitësi është i detyruar të ja dorëzojë blerësit një send të luajtshëm, dhe të caktuar përpara se të paguhet çmimi, ndërsa blerësi është i detyruar që shitësit të ja paguajë çmimin me këste.⁶⁶ Kjo kontratë është kontratë formale, dhe si e tillë duhet të përpilohet me shkrim, me kusht që të prodhojë efekt juridik në mes palëve kontraktuese.⁶⁷ Karakteristikë e kësaj kontrate është se kjo kontratë është dukshëm më e shprehur në ndërmarrjet ekonomike të cilat merren me prodhimin e mallrave.

Kontrata e shitjes me parapagim

Kontrata e shitjes me parapagim është po ashtu një lloj i veçantë i kontratës së shitjes ku përmes së cilës blerësi i sendit detyrohet që paraprakisht të paguajë shumën e parave për sendin e blerë, e më pas ta marrë sendin.⁶⁸ Në shumicën e rasteve kjo kontratë përdoret në blerjen e librave, ku ndërmarrjet botuese i njoftojnë personat fizik dhe juridik që të parapagohen për botimet e ardhshme.⁶⁹

Kontrata e shitjes me të drejtë të gjetjes së blerësit më të mirë

Një tjetër lloj i kontratës së shitjes është edhe kontrata e shitjes me qëllim të gjetjes së blerësit më të mirë. Kjo kontratë ka për qëllim ruajtjen e vlerës së sendit nga ana e shitësit, sipas kësaj kontrate në rast se dy palë shitësi dhe blerësi bien dakord që të shesin një send në një shumë të caktuar, ndërsa më vonë del një blerës tjetër që e rrite shumën e parave për atë send, shitësi ka të drejtë që atë shend ta shesë drejt blerësit më të mirë. Përmes kësaj kontrate shitësi e rezervon të drejtën që të heqë dorë nga kontrata në rast se në një afat të caktuar do ta gjejë një blerës më të mirë.⁷⁰ Pra, kjo kontratë ka për qëllim mbrojtjen e vlerës së sendit brenda tregut, në rast se rritet vlera e sendit brenda një

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 409, Prishtinë 2008.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 313, Prishtinë 2008.

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ Dr.sc. Nerxhivane Dauti, “E drejta e detyrimeve”, f. 314, Prishtinë, 2008.

afati të caktuar dhe del një blerës tjetër i cili jep një shumë më të madhe të të hollave.

Kontrata e shitjes sipas mostrës dhe specifikacionit brenda tregut

Kontrata e shitjes sipas mostrës apo modelit është një lloj i veçantë i kontratës së shitjes, ku përmes kësaj kontrate blerësit i dorëzohet sendi në atë formë që është specifikuar me kontratë, konkretisht sipas atij modeli në të cilin palët kontraktuese janë dakorduar. Kjo kontratë ka për qëllim mbrojtjen e pozitës së shitësit dhe blerësit në momentin kur ata bien dakord për shitblerje të një sendi, që ka karakteristika të posaçme sa i përket modelit apo mostrës. Nëse palët bien dakord që ta sjellin në treg një send specifik për nga mostra dhe modeli, dhe në rast se pala shitëse dështon ta sjellë një send të tillë, apo nuk e sjellë një send ashtu siç palët janë marrë vesh me kontratë, shitësi përgjigjet për mungesa fizike apo materiale të sendit sipas dispozitave për mospërbushjen e detyrimit.⁷¹ Shitësi nuk përgjigjet për të metat e njëjtësisë në qoftë se mostrën përkatësisht modelin ja ka paraqitur blerësit vetëm për qëllim njoftimi dhe caktim të përafërt të karakteristikave dhe njëjtësisë, kjo e parapare në nenin 521 të LMD-së.⁷² Cilësia e sendit të dorëzuar vërtetohet sipas modelit, i cili shënohet me vulën e palëve kontraktuese në etiketën dhe nënshkrimin e palëve kontraktuese dhe ka natyrën e modelit autentik.⁷³ Kontrata e shitjes sipas mostrës ka një rëndësi mjaft të madhe në treg për shkak të kërkesave të mëdha të ndërmarrjeve në saktësimin e mallit sipas një modeli apo mostre konkrete. Në ditët e sotme ku çdo ditë e me tepër po afirmohet teknologjia dhe mjetet e informimit njerëzit shohin sende të cilat u përkasin modeleve të ndryshme dhe të cilat kanë karakteristika dhe specifika të veçanta, prandaj edhe kërkesat janë më të mëdha. Kjo kontratë u mundëson njerëzve që dëshirojnë të blejnë që sendin ta marrin sipas karakteristikave të kontraktuara. Përveç kontratës së shitjes sipas modelit, edhe kontrata e shitjes sipas specifikacionit si një lloj i veçantë i kontratës së shitjes

⁷¹ Shih “*Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve*” të Republikës së Kosovës, nënkreu 3, neni 521, par. 1 dhe 2, ku flitet për kontratën e shitjes në bazë të mostrës apo modelit, në të cilin theksohet se në rast se shitësi nuk e sjellë sendin sipas modelit të kontraktuar, atëherë shitësi do të përgjigjet për mungesat materiale të sendit, shih dhe paragrafin 2 ku ceket se shitësi nuk përgjigjet për të metat e sendit në rast se modelin ja ka paraqitur blerësit vetëm me qëllim njoftimi të karakteristikave të jashtme.

⁷² Po aty.

⁷³ Nerxhivane Dauti, “*E drejta e detyrimeve*”, f. 408, Prishtinë, 2008.

lidhet në mes shitësit dhe blerësit përmes së cilës blerësi e rezervon të drejtën që në të ardhmen të caktojë formën, masën si dhe detajet e tjera të sendit.⁷⁴ Kjo kontratë ka një impakt të rëndësishëm në treg. Lënda e kontratës së shitjes sipas specifikacionit caktohet vetëm në bazë të llojit dhe sasisë.⁷⁵ Kur lidhet kontrata e shitjes sipas specifikacionit, jepet specifikacioni nga ana e shitësit. Përmes specifikacionit shitësi cakton cilësitë e sendit të blerë, konkretisht specifikacioni është një deklaratë e shitësit përmes së cilës shitësi deklaron për së afërmi cilësitë e sendit të blerë.⁷⁶ Specifikacioni mund të jepet me shkrim por edhe gojarisht.⁷⁷ Në qoftë se me kontratë është rezervuar e drejta për blerësin që të caktojë më vonë formën, masën ose ndonjë karakteristikë tjetër të sendit, ndërsa blerësi nuk e kryen këtë specifikim deri në datën e kontraktuar, ose derisa të kalojë një afat i arsyeshëm, shitësi mund të deklarojë se e zgjidhë kontratën, ose detyrohet të bëjë specifikimin sipas asaj që është në dijeni për nevojat e blerësit.⁷⁸ Ndërsa, në rast se vet shitësi kryen specifikimin, ai ka për detyrë ta njoftojë blerësin mbi hollësitë e tij dhe t'ia caktojë një afat të arsyeshëm që të bëjë një specifikim tjetër.⁷⁹ Në qoftë se blerësi nuk e shfrytëzon këtë mundësi, mbetet i detyruar specifikimi të cilin e ka bërë shitësi.⁸⁰ Kontrata e shitjes sipas specifikacionit brenda tregut ka për qëllim lënien e mundësisë drejt blerësit që të lidhë këtë kontratë dhe kështu me vonë të caktojë formën, masën apo detajet e tjera të sendit.

Conclusion

Through this project was emphasized the role and importance of the contract as a support base for parties, on fulfilling obligations in a two-sided contractive relationship. It is worth mentioning that this project contains comparative parts between Kosovo's legislation that belongs to the scope of contract relations and the one of USA in the part where is discussed about the rights and seller's obligations for buyers. Kosovo as a new state in the process of law-making has affirmed the

⁷⁴ Dr.sc Nerxhivane Dauti, "*E drejta e detyrimeve*", f. 311, Prishtinë, 2008.

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Shih, "*Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës*", nënkreu 4, neni 522, par.1.

⁷⁹ Dr.sc Nerxhivane Dauti, "*E drejta e detyrimeve*", f. 311, Prishtinë, 2008.

⁸⁰ Shih, "*Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës*", nënkreu 4, neni 522, par.2 dhe 3.

western legislation values in the field of contracting and nowadays lawyers or professional people are working on creation of Civil Code of the Republic of Kosovo, where is expected that the laws of civil scope to be imposed within this code to facilitate the work of judiciary and other justice actors on interpretation of these acts and other norms belonging to the civil field. By this project, it is resulted that the purchase contract is a very significant contract because it is the most expressive contract with a wide impact both in the Kosovar market and in the markets of developed countries. This contract is seen as a fundamental and important regulator of rules implementation, positively the rights and obligations between the contracting parties to protect the position of the parties from the misconduct of other persons. Thus, through this contract, people create greater security in the sale and purchase of items because in case of uncertainties rely on the same contract, namely in the provisions of this contract which enables the contracting parties to become acquainted with the rights and their obligations. Premises for the future remain in the ability to increase the productive capacities Kosovo's state in order to participate in developed markets, whereby contracts that are less expressed in our markets will consequently, be implemented.

Bibliografia

1. **Marvin A. Chirelstein**, Concepts and case analysis in the law of contracts, 7 edition, 2013.
2. **Dr.sc. Nerxhivane Dauti**, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme dhe e veçantë, botim i plotësuar dhe ndryshuar, Prishtinë, 2008.
3. **Sir William R. Anson, Chicago Callaghan and Company**, Principles of the law of contract, 1880.
4. **Dr. Abdulla Aliu**, E drejta civile, Prishtinë, 2013
5. **Dr. Ivo Puhani**, E drejta romake, Prishtinë, 1988.
6. <https://legal-dictionary.thefreedictionary.com/Sales+Law>
7. **Charles, M.Fox**, Working With contracts, What law school doesn't teach you, second edition, practising law institute, 2nd edition, 2008.
8. **Richard Stim**, Contracts: The Essential Business Desk Reference, 2010.
9. **Stephen Guth**, The Contract Negotiation Handbook, USA, 2008.

10. Dr. Armand Krasniqi, Natyra juridike dhe rëndësia e kontratës për menaxhimin e ndërmarrjeve biznesore në veshtrim teorik-praktik, e disponueshme në http://www.dukagjinicollege.eu/empirikus1/269_279_armand_krasniqi.pdf

11. Brunela Kullolli, “Interpretimi i Kontratave”-Studim Krahasues”, Universiteti i Tiranës, 2017. E disponueshme edhe në <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2018/02/Interpretimi-i-Kontratave-Studim-Krahasues-Brunela-Kullolli.pdf>

12. Merryman, John, Henry & Rogelio Perez-Perdomo “Tradita e së drejtës civile”, (The Civil Law Tradition), përkthyer nga Stavri Pone dhe Irena Kola, Tiranë, 1993.

13. <https://finance.zacks.com/seller-buyback-11079.html>.

AKTE NORMATIVE

1. Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Republikës së Kosovës, **04/L-077**, Prishtinë, 2012.

2. Ligji për mbrojtjen e konsumatorit i Republikës së Kosovës, **04/L-121**, Prishtinë, 2012

3. Uniform Commercial Code of United States, 1952.

4. Kodi Civil Gjerman (BGB), Civil Code in the version promulgated on 2 January, 2002.